

NJOFTIM Nr. 2339 Prot. date 27.03.2020

Në vijim të Njoftimit Nr. 2245 Prot., datë 12.03.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik (në vijim "APP") mbi shpalljen e procedurave të reja të prokurimit publik, apo vijimin e procedurave apo kontratave në proces, në mbështetje të nenit 13 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, APP sqaron si më poshtë vijon:

Autoritetet kontraktore mund të pezullojnë apo shtyjnë afatin e pritjes së ofertave për procedurat e prokurimit që kanë shpallur, nëse për shkak të situatës së krijuar në vendin tonë, vlerësojnë se janë në pamundësi të vijimit normal të punës, ndërkohë nuk ka pengesë për asnjë autoritet kontraktor që të shpallë apo zhvillojë procedura prokurimi, për sa kohë vlerësohet e nevojshme dhe e mundur.

Në kuptim të sa më sipër, në rast se, autoritetet kontraktore vlerësojnë se janë në kushtet të vijnë me shpalljen e njoftimeve të reja për procedurat e prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik, apo me hapjen dhe shqyrtimin ofertave të paraqitura, për procedurat në proces, të vijnë me punën në sistemin e prokurimit elektronik.

Për këtë qëllim, sjellim në vëmendjen e të gjithë autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë se, sistemi i prokurimit elektronik është në punë (on line) 24 orë, çdo ditë të javës. Po kështu dhe stafi i APP-së është në dispozicion për çdo kërkesë për asistencë, pyetje apo paqartësi, të cilat mund t'i dërgoni në adresën e-mailit: info.app@app.gov.al.

Duke ju falënderuar,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reida Kashta